

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014 dhe në zbatim të nenit 2 paragrafit 5 të Rregullores nr. 04/207 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës së Gjilanit nxjerrë këtë:

**VENDIM
PËR
MBËSHTETJE FINANCIARE TË DREJTËPËRDRETË PËR OJQ "KHAM"**

1. Me këtë vendim bëhet mbështetja financiare e drejtpërdrejtë për OJQ "KHAM" për nderë të 8 prillit "Ditës Ndërkombëtare të Romëve".
2. Mbështetja financiare bëhet në vlerë prej **300,00€** (treqind euro).
3. Shuma e mjeteve nga pika 2 e këtij vendimi paguhet nga mjetet buxhetore – subvencione nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjilanit.
4. Mjetet derdhen në xhirollogari: **1507001006515476** Raiffesen BANK.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyrtari/rja financiar/e që menaxhon me disponueshmërinë e mjeteve financiare te zyra e kryetarit.

Me këtë vendim të njoftohen:
-DBF dhe,
- Arkivi Komunal.




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kryetari i Komunës në zbatim të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, nxjerrë:

V E N D I M
PËR PAGESAT TJERA NË RRETHANA TË VEÇANTA

I

Nëpunësit civil, z. Nebi Hasani i caktuar në detyra punuese Zyrtar i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, **I lejohet** ndihma monetare në lartësi të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil komunal, në shumën prej 369 € për shkak të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babai), Qamil Hasani me datë **23.03.2018**.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Certifikata nga libri amzë i të vdekurve nr. i referencës **4/2018RV/4001 e datës 28.03.2018**, lëshuar nga Shërbimi i gjendjes civile në DAP- Gjiçan.

III

Pagesa duhet bërë nga kodi buxhetor Subvencione ose Mallra dhe shërbime i DAP në xhirollogarinë rrjedhëse të shërbyesit civil e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.


Vendimi t'i dorëzohet:

- Drejtorit të DAP
- Shërbyesit civil
- Në dosje




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE
GI 651 18 015 225

Pastrimi i rrugëve trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese në Komunën e Gjiçanit

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

- | | |
|-------------------|----------------------|
| 1. Nazmi Halili | kryetar i komisionit |
| 2. Zijadin Maliqi | anëtar i komisionit |
| 3. Shqipe Hoxha | anëtare e komisionit |

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimin të këtij vendimi

Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.


Jehona Hyseni

Drejtor i Departamentit të Prokurimit




Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE
Servisimi i automjeteve te Komunës se Gjilanit
GL 651 18 014 221

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Kujtim Bajrami kryetar i komisionit
2. Shkodran Idrizi anëtar i komisionit
3. Nazif Osmani anëtar i komisionit

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsye që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimit të këtij vendimi


Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

Gjilan 28 /03/2018

Jehona Hyseni

Zyrtar i Prokurimit



Lutfi Haziri


Kryetari i Komunës



02 Nr./Br.No. 326

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL, nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës të Gjilanit, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës në zbatim të nenit 90 paragrafi 2 nënparag. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M
P Ë R
P Ë R F U N D I M I N E M A R R Ë D H Ë N I E S S Ë P U N Ë S

1. Nëpunësit civil, **znj. Mirishahe Shala** e lindur më: **11.04.1953**, e caktuar në detyra të punës, **Asistente administrative** në kuadër të **Drejtorisë për Arsim i Përfundon** punësimi në Shërbimin Civil Komunal më: **11.04.2018** sipas fuqisë së ligjit - **Pensionimi**.
2. Nëpunësit civil të pensionuar i takon e drejta e një page shtesë për pensionim në shumë prej një page mujore të njehershme në vlerë të pagës së fundit para pensionimit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, **znj. Mirishahe Shala** e caktuar në detyra punuese Asistente administrative në kuadër të **Drejtorisë për Arsim** ka arritur moshën **65** vjeçare, moshën e pensionit më datë: **11.04.2018** dhe sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është caktuar shkuarja në pensionin e merituar me të drejtën e pagesës së një page shtesë për shkak të pensionimit. Organi i punësimit, pas shqyrtimit të shkresave në dosjen personale të të punësuarit, konstatoi se; nëpunësi civil ka arritur moshën e pensionimit, andaj në bazë të nenit 90 paragrafi 2 nënparagrafi. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil dhe nenin 19 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të tjera të Nëpunësve Civil, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë komisionit të ankesave, brenda autoritetit komunal në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

VENDIMI T'I DORËZOHET:

- DA
- Nëpunësit civil
- Njësisë së personelit




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Bazuar në nenin: 1, paragrafi 1 dhe 2 nenin: 3,4,5 dhe paragrafi: 1-4, neni 7,8 dhe 21 të Rregullores Komunale për subvencione, **nr: 01-nr:16/126422, datë: 29.12.2016**. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së **z: Valbon Milazimi nr: 02-016/01-0027417/18, datë: 20.03.2018**. për mbështetje financiare për shërim, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

1. APROVOHET- kërkesa e **z. Valbon Milazimi** nga Gjiçani, **nr: 02-016/01-0027417/18, datë:20.03.2018**, dhe të njejtit i lejohet ndihma financiare në lartësi prej: **700 € /shtatqindëeuro/** për shërim të fëmijut.

2.Pagesa e mjeteve do të bëhet nga kodi për subvencione i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

A r s y e t i m

z. Valbon Milazimi nga Gjiçani, me kërkesën **Nr: 02-016/01-0027417/18, datë:20.03.2018**. iu ka drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës, për mbështetje financiare për shërim të djalit të sëmurë **Rigon Milazimi** i lindur më: 21.08.2009 v pasi që për shkak të gjendjes ekonomiko sociale në të cilën gjendet nuk po ka mundësi që ti mbuloi shpenzimet të cilat po i nevojiten për sigurimin e terapis së nevojshme për shërim..

Kryetari i Komunës mbështetur në faktet e cekura më lartë vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pa kënaqur në këtë vendim ka të drejtë ankese komisionit komunal për ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njejtit.

VENDIMI TI DORZOHET:

- Palës _____
- Shërbimit financiar
- Arkivës





Kryetari i Komunës:

z. Lutfi Haziri /



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të LVL, Kryetari i komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës, e në zbatim të nenit 40 paragrafi 1 nënparagrafi. 1.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-149, dhe nenit 12 paragrafi. 1 dhe 2 nënparagrafi, 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Rregullores nr. 06/2011 për Pushimet e nëpunësve civil, merr këtë:

V E N D I M P Ë R CAKTIMIN E PUSHIMIT TË LEHONISË

1. Nëpunëses civile, znj. Semra Halili e caktuar në pozitën punuese, Arkiviste në D.A.P i **CAKTOHET**, pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej **12** muajve sipas Fletë lëshimit të Spitalit Regjional, Reparti i Obstetrikës në Gjilan nr. **02-428** dt. **27.03.2018**.
2. Nëpunëses civile për 6 muajt e parë të Pushimit të lehonisë prej datës; **23.03.2018** e gjer më datën; **22.09.2018** i takon kompensimi nga institucioni Komunal në lartësi prej **70%** të pagës bazë të saj.
3. Tre muajt në vijim prej; **23.09.2018** e gjer më; **22.12.2018** paguhet në lartësi prej **50%** të pagës mesatare në Republikën e Kosovës nga Qeveria.
4. Tre muajt e tjerë në vijim prej; **23.12.2018** e gjer më; **23.03.2019** mund të merret me kërkesën e nëpunëses civile pushim pa pagesë.
5. Nëse nëpunësja civile nuk dëshiron ta shfrytëzoj të drejtën në pushim të lehonisë nga pika 3 dhe 4 e këtij vendimi duhet ta njoftoj Udhëheqësin e saj të drejtpërdrejtë më së voni **15** ditë para përfundimit të pushimit nga pika 2 e këtij vendimi.
6. Nëse nëpunësja civile nuk e shfrytëzon pushimin e lehonisë nga pika 3 e këtij vendimi asaj mund ti jepet pushim prej **2** orë pune në ditë brenda orarit punues dhe **1** orë në ditë nëse nuk e shfrytëzon të drejtën e përcaktuar të pushimit në pikën 4 të këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Njësia e personelit


Vendimi të i dorëzohet:

- Nëpunëses civile,
- Drejtorit të D.A.P
- Në dosje




Kryetari i Komunës,

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim Asociacionit të Agjencive për Demokraci Lokale (Association of Local Democracy Agencies –ALDA) i paguhet kuota e anëtarësisë në vlerën monetare prej 1,200€ (njëmijedyqind euro).
2. Shuma në vlerën monetare prej 1,200€(njëmijedyqind euro) nga pika 1 e këtij vendimi ekzekutohet përmes transferimit ndërkombëtar e cila ka këto të dhëna: Bank Credit Mutuel,Address Strasbourg,Bank Code 10278, Agency Code 01084, Individual account: 00020176501, IBAN FR76 1027 8010 8400 0201 7650 153, SWIFT: CMCIFR2A.
3. Shuma e mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi merret nga mjetet e Zyrës së Kryetarit (kodi për mallra dhe shërbime).
4. Komuna e Gjiçanit përmes Asociacionit të Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA), është bërë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të njerëzve të angazhuar për zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal, nga se ALDA është pjesë integrale e Këshillit të Evropës.
5. Komuna e Gjiçanit si anëtare e plotë përfiton nga praktikat më të mira, nga se ALDA është e angazhuar për të promovuar praktika të tilla, si përmirësimi i qeverisjes në përgjithësi, përfshirja e metodave efikase për publikun, diskutimet në veçanti në rritjen e rolit të shoqërisë civile.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
7. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- DBF -së
- DZHA-së
- Arkivit



Kryetari i Komunës
Lutij Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Grant kontratës të BE-së nr. 2017/394-657, Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjiçanit dhe Komunës së Kumanovës 02 nr. 254 dt. 28.02.2018 për projektin “Tregu i qëndrueshëm për prodhimet e freskëta të fermerëve në zonën ndërkuftare në Komunën e Gjiçanit dhe Komunën e Kumanovës” Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

PËR
BARTJEN/TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE

1. Me këtë vendim bëhet bartja/transferi i mjeteve financiare në vlerë prej **82.636,63** nga Komuna e Gjiçanit në Komunën e Kumanovës.
2. Mjetet financiare nga neni 1 i këtij vendimit, janë mjete financiare të ndara nga Granti i BE-së, e që vlera e këtij Granti është **174.352.67 €**.
3. Pjesë e këtij vendimi është MM në mes të Komunës së Gjiçanit dhe Komunës së Kumanovës 02 nr. 254 dt. 28.02.2018 dhe Grant kontrata e BE-së 2017/394-657.
4. Transferi i mjeteve financiare bëhet në IBAN kod MK07100701000067003, SWIFT kodi NBRMMK2A.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- DZHE-së
- Arkivit




Kryetari i Komunës
Lutë Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Bazuar në **nenin 13**. Të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr: **03/L-040**, **nenit 78**, **paragrafi 1** të Statutit të Komunës së Gjiçanit, lidhur me pagesën e subvencioneve për rastet për personat fizik për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore, mbështetur në Rregulloren komunale për subvencione Nr: **01-016-144327 datë: 30.12.2014**, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

-I-

Me këtë Vendim të bëhet pagesa e mjeteve financiare në vlerë totale prej: **1020 €**, me shkronja /**njëmijënjëzetëeuro**/ sipas regjistrit të rekomanduar nga komisioni e të aprovuar nga ana e kryetarit të Komunës nr: **04-5553/01-0025007/18**, datë: **14.03.2018**, për rastet e ndihmave për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore sipas Rregullore komunale për subvencione nr:**01-016-144327**, datë:**30.12.2014**,

-II-

Pagesa e mjeteve sipas këtij vendimi bëhet nga kodi për subvencione i DSHMS-së

-III-

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi financiar i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.


-IV-

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës




Kryetari i Komunës:

Z. Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE
Ora për Sahat Kullën, instalimi dhe konfigurimi i sistemit
GL 651 18 011 121

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Muhamet Pajaziti kryetar i komisionit
2. Saranda Rashiti anëtare e komisionit
3. Ahmet Aliu anëtar i komisionit

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsytet që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimit të këtij vendimi

Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

Gjilan 27/03/2018


Jehona Hyseni

Zyrtar i Prokurimit




Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 4 të udhëzimit administrativ i MASHT, Nr. 08/2014, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR INTERVISTIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR POZITAT : DREJTORË TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO ARSIMORE DHE AFTËSUESE "SVETI SAVA", "BOZHURI" DHE SHKOLLA E MJEKËSISË

I

Me këtë vendim, emërohet komisioni për zhvillimin e procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozitat : Drejtorë të Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese Sh.f. "Sveti Sava", IP "Bozhuri" dhe Shkolla e Mesme e Mjekësisë , sipas konkursit të shpallur publik me datë : 02.03.2018 në Radio Televizionin PULS", në këtë përbërje :

1. Xhelal Jetishi, Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë të Agrobiznesit "Arbëria" në Gjilan, kryesues i komisionit
2. Mita Kovaqeviq, Zyrtar i Arsimit për Komunitetin Serb në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, anëtar.
3. Anëtar i tretë përcaktohet nga MASHT-i

II

Komisioni përgjegjës ka për detyrë menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, përcaktimin e orarit të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse e suksesshëm për kandidatin etj.


III

Ky vendim hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.


Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 4 të udhëzimit administrativ i MASHT, Nr. 08/2014, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR INTERVISTIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR POZITAT : DREJTORË TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO ARSIMORE DHE AFTËSUESE “ MARIN BARLETI” DHE “ ADEM KASTRATI “ NË GJILAN

I

Me këtë vendim, emërohet komisioni për zhvillimin e procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozitat : Drejtorë të Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese SH.M.L Ekonomike “Marin Barleti” dhe SH.M.L Arti Pamor “Adem Kastrati” në Gjilan, sipas konkursit të shpallur publik me datë : 02.03.2018 në gazetën “Bota Sot”, në këtë përbërje :

1. Xhelal Jetishi, Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë të Agrobiznesit “Arbëria” në Gjilan, kryesues i komisionit
2. Lumnije Tahiri, Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan, anëtare.
3. Anëtar i tretë përcaktohet nga MASHT-i

II

Komisioni përgjegjës ka për detyrë menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, përcaktimin e orarit të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse e suksesshëm për kandidatin etj.

III

Ky vendim hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri

